

[REDACTED]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHER

Nr. 537 Date. 2 11.2001

Per

Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Sh.A "Ujesjellesi" Sarande

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926 , date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr.1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996 dhe nenit 164 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem

URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.A "Ujesjellesi" Sarande te behen ndryshimet e meposhtme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 65.000.000 leke e barabarte me 65.000 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A "UJESJELLESI" Sarande te behet nga 157 000 000 leke ne 222 000 000 leke e barabarte me 222 000 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.

3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 24688/2 Akt.

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 21. 11. 2001 une, gjyqtare e Gjykeses se Rrethit Tirane E. Beqaj, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zv/ Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z. Pajtim BELLO lidhur me depozitimin ne regjistrin tregtar te urdhrin Nr. 537 , date 02.11.2001 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z. Mustafa MUÇI dhe

Konstatova:

Se me vendimin Nr. 24 688 date 27.10.2000 te Gjykeses se Rrethit Tirane, Shoqeria Anonime "Ujesjellesi" Sarande eshte regjistruar si person juridik. Me urdhrin Nr.537 , date 02.11.2001 eshte vendosur zmadhimi I kapitalit te shoqerise per vleren 65 000 000 leke dhe kapitali themeltar behet 222 000 000 leke e barabarte me 222 000 000 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.

Nga shqyrtimi I akteve te paraqitura nga kerkuesi rezulton se ato jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

Per kete arsye:

Ne baze te nenit 24 te Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993

VENDOSA:

Depozitimin e Urdhrit Nr.537 , date 02.11.2001 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me ndryshimin ne aktin e themelimit te Sh.A. "Ujesjellesi" *me Statut.* Sarande, duke bere shenimin ne fleten e regjistrin ne kollonen 4 dhe 5 me Nr rendor 2. *Beqaj*
Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri.
Te publikohet vendimi I mesiperm.

GJYQTARE

E. Beqaj

Beqaj

RAPORT
I
EKSPERTIT KONTABEL

Ne te quajturit Leze Abazi dhe Ahmet Stojna, eksperte kontabel te autorizuar te ngarkuar me detyren e verifikimit dhe vertetimit te bilancit te Shoqerise Ujesjelles-kanalizime Sarande qe krijohet nga transformimi I Ndermarrjes se Ujesjellesit Sarande paraqesim raportin tone si vijon :

Nga data 28.04.1999 deri me daten 5 Shtator 2000 kemi ndjekur punen e komisionit te ndermarrjes lidhur me percaktimin e kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi I saj.

Nga ana jone u kontrolluan te gjitha dokumentat e pergatitura nga ndermarrja per percaktimin e kapitalit te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes se Ujesjellesit Sarande ne SHA. Nga verifikimet e bera konstatuam se Komisioni i Vleresimit te pasurise shteterore, i ngritur posacerisht ne ndermarrje ka respektuar rregullat e percaktuara ne VKM Nr. 194 date 20.03.1998 si dhe te Udhezimit te MEPP Nr.1 date 15.05.1998 "Per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar te shoqerive shteterore qe do te krijohen nga shnderrimi i ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare"

Rregjistrimet kontabile lidhur me percaktimin e kapitalit jane kryer ne menyre te plote dhe te rregullt.

Bilanci I celjes se Shoqerise qe do te krijohet si pasoje e transformimit te Ndermarrjes se Ujesjellesit Sarande jep nje pamje besnike te pasurise dhe te gjendjes financiare te ndermarrjes.

Kapitali I percaktuar prej 157.000.000. leke I pergjigjet vleres se aktivitet neto te shoqerise.

Sarande me 8 Shtator 2000

Eksperte Kontabel e Autorizuar

Ekspertet Kontabel te Autorizuar
LEZE ABAZI
S A R A N D E

Leze ABAZI
Ahmet STOJNA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH.A
ASAMBLEJA E PERGJITHSME E AKSIONEREVE
S A R A N D E

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE UJESJELLES - KANALIZIME Sh.a SARANDE
Nr. 1, date 16.03.2018

Sot me date 16.03.2018, u mblodh Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te shoqerise "Ujesjelles - Kanalizime" sh.a Sarande, e thirrur nga administratori z.Sheme Lulo.

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Shoqerise perbehet nga:

- Bashkia Sarande perfaqesuar nga Kryetare znj. Florjana Koka.
- Bashkia Finiq e perfaqesuar nga Kryetari z. Leonidha Hristo.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme eshte thirrur per te diskutuar dhe vendosur mbi rendin e dites si vijon:

- Miratimin e pasqyrave financiare te shoqerise per vitin 2016, se bashku me dokumentacionin perkates.
- Percaktimin fitimit te shoqerise te realizuar gjate vitit financiar 2016 per shumen 3,444,764 leke.
- Miratimin e raportit te eksperteve kontabel te regjistruar, te shoqerise F&F AUDITING Sh.P.K perfaqesuar nga z. Fatmir Sulo dhe shoqerine "Studio L.E.A.L." Shpk, perfaqesuar nga znj. Leze Abazi mbi auditimin pasqyrave financiare te shoqerise per vitin 2016.
- Emerimin e Ekspertit Kontabel te regjistruar per auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2017

Sa siper, Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve miratoi me unanimitet te plote vendimet e meposhtme:

- Miratimin e pasqyrave financiare te shoqerise per vitin 2016, se bashku me dokumentacionin perkates.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH.A
ASAMBLEJA E PERGJITHSME E AKSIONEREVE
S A R A N D E

- Percaktimin e rezultatit te shoqerise te realizuar gjate vitit financiar 2016 per shumen leke 3,444,764 leke.
- Miratimin e raportit te eksperteve kontabel te regjistruar, te shoqerise F&F AUDITING Sh.P.K perfaqesuar nga z. Fatmir Sulo dhe shoqerine "Studio L.E.A.L." Shpk, perfaqesuar nga znj. Leze Abazi mbi auditimin pasqyrave financiare te shoqerise per audimin e pasqyrave financiare per vitin ushtrimor qe eshte mbyllur me 31 Dhjetor 2016.
- Te emerohet Ekspertet Kontabel, "Shoqerine F & F Auditing shpk", perfaqesuar nga z. Fatmir Sulo, e regjistruar ne regjistrin publik te shoqerive te eksperteve kontabel te regjistruar, me Licence Profesionale Nr.228 date 08.11.2011 me Nipt L14710803C dhe shoqerine "Studio L.E.A.L." Shpk, perfaqesuar nga znj. Leze Abazi e regjistruar ne regjistrin publik te shoqerive te eksperteve kontabel te regjistruar, me Licence Profesionale Nr.24 date. 10.02.2000 me Nipt K83814801N, per miratimin e pasqyrave financiare te shoqerise per periudhen qe do te mbyllet deri me date 31.12.2017

Asambleja e pergjithshme Aksionereve ngarkon administratorin e shoqerise z. Sheme Lulo, qe ne zbatim te paragrafit 4 te nenit 33/1 te Ligjit 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", i ndryshuar dhe pikese 5.6 te Udhzimit te Ministrit te Financave Nr.5 date 30.01.2006, te autorizojte Kryetaren e Deges Finances Zhaneta Maska per te depozituar kete vendim, prane Drejtorise Rajonale Tatimore Sarande, dhe gjithashtu ne zbatim te nenit 43 dhe 44 te Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit" te depozitohet se bashku me Pasqyrat Financiare te vitit 2015 dhe kerkesat e tjera prane Qendres Kombetare te Biznesit brenda dates 31.07.2016.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

BASHKIA SARANDE

BASHKIA FINIQ

Florjana Koka



Leonidha Hristo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH.A
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE
S A R A N D E

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE "UJESJELLES - KANALIZIME" SH.A.SARANDE
Nr.2, date 16.03.2018

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a., Sarande, e mblodhur sot me daten 16.03.2018, me pjesemarrjen e aksionereve te Shoqerise, Bashkia Sarande perfaqesuar nga Kryetare Znj.Florjana Koka dhe Bashkia Finiq perfaqesuar nga Kryetari Z.Leonidha Hristo, i cili perfaqeson dhe aksioneret e tjere qe kane qene zoterues te kapitalit te shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" sh.a Sarande, dhe me ndryshimet e reja ligjore per veteqeverisjen vendore, keto komuna kane kaluar nen juridiksionin e Bashkise Finiq.

Aksioneret pasi u paraqit rendi i dites te caktuar "Per miratimin e Raportit te vleresimit per ndryshimin e Kapitalit, prone e Ujesjelles Kanalizime Sarande, ne zbatim te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, te Ligjit nr.139/2015 "Per Veteqeverisjen vendore", V.K.M. nr.63, date 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura", te Vendimit Nr.1, date 24.04.2017 te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise Ujesjelles-Kanalizime Sarande "Per rivleresimin e kapitalit Ujesjelles Kanalizime Sarande" sh.a., si dhe te Proces verbaleve te marrjes ne dorezim te grup objekteve te Ujesjellesave Ksamil dhe grup objekteve te transferuara Bashkise Finiq.

Aksioneret shqyrtuan gjithe dokumentacionin e vene ne dispozicion, lidhur me procedurat e zmadhimit te kapitalit nga marrja ne dorezim i grup objekteve te Ujesjellesave Ksamil, dhe transferimit te grup objekteve tek Bashkia Finiq.

Meqenese Njesia administrative e Ksamilit, eshte nen juridiksionin e Bashkise Sarande, kjo nuk perfiton perqindje pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise, pasi aksioneri i vetem eshte po bashkia Sarande.

Bashkia Finiq, e cila ka qene aksionere ne shoqerine Ujesjelles Kanalizime Sarande, duke ju referuar ndryshimeve ligjore sipas Ligjeve te cituara me siper, ajo perfiton vetem grup objektete

qe jane nen juridiksionin e saj, duke hequr dore perfundimisht nga pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" sh.a. Sarande. Pra, Bashkia Finiq nuk mund te jete me aksionere ne shoqerine "Ujesjelles Kanalizime" sh.a. Sarande.

Gjithashtu te fillojne procedurat per transferimin e detyrimeve (debi, kredi) kundrejt Bashkise Finiq.

Per sa me lart, ne mbeshetjet e Statutit te Shoqerise, "Ujesjelles Kanalizime" sh.a. Sarande dhe ne perputhje me ndryshimet ligjore per Veteqeverisjen vendore, si dhe te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar, aksioneret e shoqerise:

VENDOSEN

1.Miratimit e Raportit te eksperteve kontabel per percaktimin te vleres te kapitalit te shoqerise nga ndryshimet e kapitalit sipas kerkesave te ligjit per veteqeverisjen vendore.

2-Miratimin e shtimit te kapitalit te shoqerise ne vlere prej 362.304.000(treqind e gjashtedhete e dymilion e treqind e katermije) leke.

3-Miratimin e largimit te aksionereve Komuna Aliko, Komuna Finiq,Komuna Dhiver e Komuna Mesopotam te cilat behen pjese e Njesise Administrative te Bashkise Finiq:
-Komuna Aliko zoteron 0%(perqindja e zoterimit ishte 13.80% te aksioneve, behet 0%),
-Komuna Dhiver zoteron 0%(perqindja e zoterimit ishte 2.90% te aksioneve, behet 0%),
-Komuna Finiq zoteron 0%(perqindja e zoterimit ishte 10.10% te aksioneve, behet 0%),
-Komuna Mesopotam zoteron 0%(perqindja e zoterimit ishte 9.90% te aksioneve, behet 0%).

4- Kapitali i shoqerise behet prej 584.304.000 leke (ishte 222.000.000 leke dhe behet prej 584.304.000 lek), ose 222.000 aksione me vlere prej 2.632 leke secili aksioner, dhe zoterohet nga aksioneri i vetem Bashkia Sarande.

5. Te fillojne procedurat per transferimin e detyrimeve (debi, kredi) kundrejt Bashkise Finiq.

6.Gjithe dokumentacioni per shtesen e kapitalit te depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit, ne perputhje me kerkesat e Statutit te Shoqerise, kerkesa keto te shprehura ne ligj.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

BASHKIA SARANDE

BASHKIA FINIQ

Florjana Koka



Leonidha Hristo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH.A
ASAMBLEJA E PERGJITHSME E AKSIONEREVE
S A R A N D E

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE UJESJELLES - KANALIZIME Sh.a SARANDE
Nr. 4, date 16.03.2018

Sot me date 16.03.2018, u mblodh Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te shoqerise "Ujesjelles - Kanalizime" sh.a Sarande, e thirrur nga administratori z.Sheme Lulo.

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Shoqerise se perberne nga:

- Bashkia Sarande perfaqesuar nga Kryetare znj. Florjana Koka.
- Bashkia Finiq e perfaqesuar nga Kryetari z. Leonidha Hristo.

VENDOSI

- Ndryshimin e perberjes se aksionereve te Shoqerise Ujesjelles-Kanalizime sh.a Sarande, duke kaluar perqindjet e pjesemarrjes se aksioneve te ish Komunave - Dhiver (10.1%), Finiq (2.9%), Aliko (13.8%) dhe Mesopotam (9.9%) tek Bashkia Finiq, e cila do te zoterohet 36.7% te aksioneve, bazuar ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 « Per shoqerite tregtare » , i ndryshuar, ne Ligjin Nr. 115/2014 « Per ndarjen administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise » dhe V.K.M. Nr. 63 date 27.01.2016 « Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura »

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve ngarkon Administratorin e Shoqerise z. Sheme Lulo, qe ne zbatim te nenit 43 dhe 44 te Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit" te depozitohet vendimin e mesiper prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

BASHKIA SARANDE

BASHKIA FINIQ

Florjana Koka



Leonidha Hristo

RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL

Une e quajtura Leze Abazi , Eksperte Kontabel e Autorizuar, e ngarkuar me detyren e pergatitjes se raportit per zmadhimin e kapitalit themeltar te Sh.A. "Ujesjellesi" Sarande, nga vlera e pasurise se sektorit te kanalizimeve paraqes raportin tim si vijon:

Nga data 15.11.2000 deri me daten 16.Tetor 2001 kam ndjekur punen e komisionit te ndermarjes (sektorit) te kanalizimeve Sarande lidhur me percaktimin e vleres se pasurise se sektorit te kanalizimeve qe do ti bashkohet ne formen e zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise Ujesjellesi Sh.A.Sarande.

Nga ana ime u kontrolluan te gjitha dokumentat e pergatitura nga ndermarja per percaktimin e vleres se pasurise se sektorit te kanalizimeve qe do ti bashkohet shoqerise se Ujesjellesit Sh.A. Sarande.Nga verifikimet e bera konstatova se Komisioni i Vleresimit te pasurise shteterore , i ngritur posacerisht ne ndermarje ka respektuar rregullat e percaktuara ne VKM Nr. 194, date 20.3.1998, te Udhezimit te MEPP-se Nr.1 date 15.5.1998 "Per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar te shoqerive shteterore qe do te krijohen nga shnderrimi I ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregetare , te Urdherit te MEPP Nr 556 date 16.10.2000 "Pergatitjen e dokumentacionit mbi zmadhimin e kapitalit themeltar te Sh.A. "Ujesjellesi "Sarande te Udhezimit te MEPP nr 3334 date 11.06.2001 "Per administrimin e sistemit te ujesjelles -kanalizimeve".


Regjistrimet kontabile lidhur me percaktimin e kapitalit jane kryer ne menyre te plote dhe te rregullt.

Bilanci i ndermarjes (sektorit) kanalizimeve qe pasqyron vleren e pasurise qe do ti transferohet shoqerise Anonime "Ujesjellesi" Sarande ne formen e zmadhimit te kapitalit, jep nje pamje besnike te pasurise dhe te gjendjes financiare te ndermarrjes.

Kapitali qe do te transferohet ne formen e zmadhimit te kapitalit themeltar Sh.A. "Ujesjellesi " Sarande eshte 65.000.000 leke dhe I pergjigjet vleres se aktiviteti neto te sektorit te kanalizimeve.

Kapitali I nenshkruar I Sh.A."Ujesjellesi" Sarande nga 157.000.000 leke behet 222.000.000 leke duke I shtuar vleren e kanalizimeve prej 65.000.000 leke, I ndare ne 222.000 aksione me vlere nominale 1000 leke.

**Eksperte kontabel e autorizuar
Leze Abazi**


Eksperte Kontabel e Autorizuar
LEZE ABAZI
S A R A N D E